

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 3946, datë 10.6.2016

PËR MBLEDHJEN DHE RUAJTJEN E TË DHËNAVE PËR CILËSINË E LËNDËVE DJEGËSE TË LËNGËTA TË MESME TË RËNDA (*GAS OIL*), LËNDËVE DJEGËSE TË LËNGËTA TË RËNDA (*HEAVY FUEL OIL*) DHE LËNDËVE DJEGËSE TË LËNGËTA MARINË (*MARINE FUEL*)

Në zbatim të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 8, të vendimit nr. 781, datë 14.11.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngshme, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”, ministri i Energjisë dhe Industrisë, ministri i Mjedisit dhe ministri i Financave,

UDHËZOJNË:

1. Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Financave, bashkëveprojnë dhe bashkërendojnë veprimtarinë nëpër-mjet strukturave të specializuara të tyre për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave për cilësinë e lëndëve djegëse, lëndë djegëse të lëngëta të mesme të rënda (*gas oil*), lëndë djegëse të lëngëta të rënda (*heavy fuel oil*) dhe lëndë djegëse të lëngëta marinë (*marine fuel*), sipas standardeve dhe afateve kohore të përcaktuara në vendimin nr. 781, datë 14.11.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngshme, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”.

2. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (DPD) merr dhe sistemon të dhënat nga prodhuesit vendas dhe nga tregtuesit me shumicë dhe pakicë në lidhje me cilësinë dhe sasinë e lëndëve djegëse të lëngëta të mesme të rënda (*gas oil*), lëndëve djegëse të lëngëta të rënda (*heavy fuel oil*) dhe lëndëve djegëse të lëngëta marinë (*marine fuel*) për shkallën e përputhshmërisë për secilin parametër fiziko-kimik me ato në përputhje me specifikimet standarde. Një kopje e këtyre të dhënave dërgohet nga ISHTI-ja çdo 6 muaj pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM).

3. Strukturat rajonale të ISHTI-së organizojnë, në bashkëpunim me strukturat rajonale të AKM-së, si dhe me DPD-në, programe pune të përbashkëta për marrjen e mostrave për cilësinë e lëndëve djegëse, të lëngëta të rënda (*heavy fuel oil*) dhe lëndëve djegëse të lëngëta marinë (*marine fuel*).

4. Strukturat përgjegjëse për aktivitetin e tregtimit, të mbledhjes dhe të analizimit të të dhënave të hidrokarbureve dhe të nënprodukteve të tyre në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, Ministrinë e Mjedisit dhe Ministrinë e Financave, organizojnë 2 herë në vit takime të përbashkëta të institucioneve të vartësisë të ngarkuara për zbatimin e këtij udhëzimi, për shkëmbimin e informacionit mbi ecurinë e zbatimit të vendimit nr. 781, datë 14.11.2012, të Këshillit të Ministrave “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngshme, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”. Konkluzionet e takimeve u raportohen ministrave përkatës.

5. Të dhënat e grumbulluara, për parametrat e lëndëve të lëngëta të mesme të rënda (*gas oil*), lëndëve djegëse të lëngëta të rënda (*heavy fuel oil*) dhe lëndëve djegëse të lëngëta marinë (*marine fuel*), analizohen nga ISHTI-ja dhe janë objekt i diskutimit në takimet e përbashkëta ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Financave sipas pikës 4 të këtij udhëzimi.

6. Rafineritë dhe shoqëritë e tregtimit me shumicë, pavarësisht detyrimeve të tjera për dërgim informacioni në institucionet shtetërore, dërgojnë pranë Inspektoratit Qendror Teknik, çdo tre muaj, informacion në lidhje me sasinë e lëndëve djegëse, të lëngëta të mesme të rënda (*gas oil*), lëndë djegëse të lëngëta të rënda (*heavy fuel oil*) dhe lëndë djegëse të lëngëta marinë (*marine fuel*), të hedhura në tregun e brendshëm.

7. AKM-ja ruan dhe administron informacionin e marrë nga ISHTI-ja dhe krijon regjistrin e

të dhënave në lidhje me sasinë dhe cilësinë e lëndëve djegëse, në përputhje me specifikimet e standardeve të secilit produkt. Një kopje e informacionit publikohet në faqen elektronike të Ministrisë së Mjedisit dhe të AKM-së.

8. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen ISHTI-ja, AKM-ja dhe DPD-ja, si dhe strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, Ministrinë e Mjedisit dhe Ministrinë e Financave.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ENERGJISË
DHE INDUSTRIË
Damian Gjikhuri

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Ahmetaj

MINISTRI I MJEDISIT
Lefter Koka